

Effective Tool in Teaching Communication

Abstract

Communication is considered effective only when students understand their teachers message correctly and respond appropriately. Effective communication helps teachers successfully manage their daily work, to improve the relationship with class students, to increase their intelligence. Effective communication helps teachers in the achievement of their success, as high up on the steps of hierarchy organization, the more important he becomes. Communication has a process that runs in 6 steps. Communication, empathy and reasoning are important elements that make effective teaching process. Dialogue and mutual support are the cornerstones of the learning process through communication. So, what teachers expect from students? Characteristics of effective communication. Communication process. Why communication is unique teaching? Reasons for making more effective communication. Communication skills of teachers as sending messages. Communication skills of teachers as recipients receiving/posts. Communication skills for understanding teachers linguistic styles. Teaching through communication. Communication of teachers yesterday and today. Communication of motivating teachers to students.

Keywords: *Communication; Teaching; Teachers; Students*

Abstrakt

Komunikimi konsiderohet efektiv vetëm kur nxënësit e kuptojnë mesazhin e mësuesit të tyre në mënyrë korrekte dhe përgjigjen në mënyrën e duhur. Komunikimi efektiv e ndihmon një mësuesit të menaxhojnë me sukses punën e tyre të përditshme, të përmirësoj marrëdhënien me nxënësit e klasë, të rris inteligjencën e tyre. Komunikimi efektiv i ndihmon mësuesit në arritjet e suksesit të tyre, sa më lartë të ngjiten në shkallët e hierarkisë organizative, aq më i rëndësishëm bëhet ai. Komunikimi ka një proces që kalon në 6 hapa. Komunikimi, empatia dhe arsyetimi janë element të rëndësishëm që e bejnë me efektiv procesin e mesimdhënies. Dialogu dhe mbështetja reciproke janë shtyllat e procesit të mësimit përmes komunikimit. Pra, çfarë presin prej mësuesit nxënësit? Karakteristikat e komunikimit efektiv. Procesi i komunikimit. Pse komunikimi në mesimdhënie është unik? Arsyet e bërjës së komunikimit më efektiv. Aftësitë komunikuese të mësuesve si dërgues të mesazhve. Aftësitë komunikuese të mësuesve si marrës/pritës i mesazheve. Aftësitë komunikuese të mësuesit për të kuptuar stilet gjuhësore. Mesimdhënia përmes komunikimit. Komunikimi i mësuesit dje dhe sot. Komunikimi i mësuesit motivues ndaj nxënësve.

Fjalët kyç: Komunikim, Mesimdhënie, Mësues, Nxënës

1-Hyrja : Arritja e sukseshme nëpërmjet komunikimit efektiv në mësimdhënie

Shumë ekspertë pohojnë se arritjet e suksesit në mësimdhënie, në ditët e sotme, varet në mënyrë të ndejshme nga aftësitë komunikuese me njerëzit, brenda dhe jashtë klasës/shkollës. Komunikimi konsiderohet efektiv vetëm kur nxënësit e kuptojnë mesazhin e mësuesit të tyre në mënyrë krrekte dhe përgjigjen në mënyrën e duhur. Komunikimi efektiv e ndihmon një mësuesit të menaxhojnë me sukses punën e tyre të përdutshme, të përmirësoj marrëdhënien me nxënësit e klasës, të rris inteligjencën e tyre. Komunikimi efektiv i ndihmon mësuesit në arritjet e suksesit të tyre, sa më lartë të ngjiten në shkallët e hierarkisë organizative, aq më i rëndësishëm bëhet ai.

2-Çfarë presin prej mësuesit nxënësit?

Pavarësisht sa i aftë jemi në mësimdhënie, nxënësi pret nga ju të jeni i aftë të kryeni me sukses një sërë detyrash të lidhura me komunikimin. Po rendisim më poshtë disa nga këto aftësi:

- Organizimi i ideve dhe informacionit në mënyrë logjike dhe të plotë, ka të bëjë gjetjet, përpunimin dhe organizimin e metodave të reja që dalin për një mësimdhënie të efekshme, më mënyrë të tillë që mësimi të bëhet i kuptueshëm nga të gjithë nxënësit.
- Shprehja dhe prezantimi i ideve dhe informacionit në mënyrë bindëse dhe koherente, është e nevojshme që sa herë të kërkohet një përgjigje nga nxënësi duhet që përgjigja të jetë e saktë dhe me argument bindës.
- Të dëgjuarit e të tjerëve në mënyrë efektive, është shumë më e vështirë nga sa mendohet dhe kërkon zhvillimin e aftësive specifike tek nxënësi dhe mësuesi.
- Komunikimi efektiv me nxënës të të profileve dhe të prejardhjeve të ndryshme, përfshin aspekte që lidhen me dallimet gjinore, etnike, kulturore, mësimmxënien etj.
- Respektimi i standarteve të pranuar të gramatikës, drejtshkrimit, aspekteve të tjera të të shkruarit dhe të folurit me cilësi të lartë mund të jetë thelbësore sidomos kur prezantohemi për herë të parë në një mjedis të ri.
- Komunikimi në mënyrë të civilizuar, duke respektuar etikën e mësimdhënies në shkollë, është shumë e nevojshme.

3-Karakteristikat e komunikimit efektiv

Për të dhënë një mesazh efektiv, ai duhet të jetë praktikë, i faktuar, konciz, i adresuar dhe bindës. Më poshtë jashtë renditur pesë rekomandime të rëndësishme:

- Jep informacion praktik, pavarësisht nëse ka të bëjë me kuptimin e politikave të mësimdhënies apo për nxitjen për kryerjen e një hapi të caktuar në mësimdhënie.

- Jep më tepër fakte dhe më pak përshtypje, duke përdorur shprehje konkrete, informacion të qartë, bindës, të saktë dhe etik.
- Qartëso dhe përqëndro informacionin duke theksuar informacionet më të rëndësishme për një mësimnxënie të efekshme.
- Bindi nxënësit dhe jepi rekomandime, duke iu shpjeguar dëgjuesve se çfarë përfitimesh ato do të kenë nga përgjigja ndaj mesazhit tuaj në mënyrën e dëshiruar.

4-Procesi i komunikimit

Cila do qoftë forma e komunikimit, procesi i komunikimit lidh dërguesin e mesazhit me marrësin nëpërmjet gjashtë fazave.




Figura. 1.1. Procesi i komunikimit

1. Mësuesi ka një ide dhe dëshiron t'ia komunikojë atë dikujt.
2. Mësuesi e kodon idenë, duke zgjedhur fjalët, simbolet, stilin që i mendon si të përshtatshme.
3. Mësuesi e transmeton mesazhin nëpërmjet një kanali komunikimi (gjuhë)
4. Mesazhi mbërrin tek nxënësi, nëse nuk ndesh barrier gjatë rrugës (mungesë vëmendje)
5. Nxënësi e dekodon mesazhin, domethënë përpiqet të kuptojë idenë e tij. Nxënësi e interpreton mesazhin në mënyrë korrekte nëse ai u jep fjallën dhe simbolet të të njëjtit kuptim si mësuesi.
6. Marrësi dërgon feedback, një përgjigje mbi mënyrën si e kupton mesazhin e marrë. Feedback-u na lejon të vlerësojmë efektivitetin e një mesazhi të transmetuar.

5- Pse Komunikimi në Mësimdhënie është Unik?

1. Ndryshimet ndërmjet nxënësve si rezultat i gjinisë, besimit fetar, kulturës, mësimnxënies etj. Përkufizohet si diversitet i nxënësve në klasë dhe trajtohen me mjaft vëmendje dhe kujdes në klasë. Në lidhje me këtë, mësimdhënësit e suksesshëm kanë kuptuar dy gjëra:

- Sa më e diversifikuar të jetë klasa aq më shumë vëmendje i duhet kushtuar komunikimit
- Mësimnxënia e diversifikuar mund të jetë një avantazh konkurrues (më shumë ide dhe këndvështrime të ndryshme).

2. Vlera në rritje e informacionit në mësimdhënie dhe në mësimnxënie:

Informacionet në vlerë të mësimdhënies dhe mësimnxënies kanë të bëjnë më konkurrencën, nevojat e nxënësit etj.

3. Evoluimi i strukturave të mësimdhënies që përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet nxënësit dhe mësuesit brenda klasës dhe shkollës.

Këto marrëdhënie, nga ana e tyre, ndikojnë në natyrën dhe cilësinë e komunikimit në klasë/shkollë. Pavarësisht nga lloji strukturës së mësimnxënies, cilësia e komunikimit në klasë/shkollë do të ndikohet nga kultura e klasës/shkollës.

4. Barrierat e komunikimit efektiv janë të shumta.

Më tipiket kanë të bëjnë me shpërqëndrimet (të shkaktura nga zhurma në klasë, në oboorin e shkollës, në korridor, nga jashtë shkollës etj.), mbingarkesa e informacionit, ndryshimet gjyhesore, etj.

6- Arsyet e Bërjes së Komunikimit më Efektiv

Nuk egziston një zgjidhje e vetme që të ndihmojë eliminimin e barrierrave në komunikim. Megjithatë, një kombinim kujdesëshëm strategjive mund të përmirësojë ndjeshëm aftësitë tuaja për të komunikuar në mënyrë të efektive.

- Në minimizimin e shpërqëndrimeve mund të ndihmojë çdo nxënës, duke u përpjekur të reduktojë zhurmat, problemet vizuale, ndërprerjet e panevojshme.
- Marrja në konsideratë e numrit të madh të nxënësve në klasë ka të bëjë me fokusimin dhe kujdesin për nxënësit që ta maarin informacionin e mësuesit në mënyrën më të drejtë dhe më të qartë.
- Perfeksioni i aftësive vetjake komunikuese në mësimdhënie arrihet gradualisht dhe lidhet me punën këmbëngulëse dhe përvojën e mësuesit.
- Marrja/dhënia e feedback-ut konstruktiv që quhet ndryshe edhe kritikizëm konstruktiv, fokusohet në procesin dhe rezultatet e komunikimit dhe jo tek nxënësit që janë përfshirë në të.
- Njohja dhe aplikimi i etikës së mësimdhënies nuk është asnjeherë e tepërt dhe ndikon në mënyrë thelbësore në suksesin individual dhe të kompanisë.

6- Aftësitë Komunikuese të Mësuesve si Dërgues të Mesazheve:

- Dërgo mesazhe që janë të qarta dhe complete;
- Kodoji mesazhet në simbole dhe në një gjuhë që është e kuptueshme për marrësin e mesazhit;
- Zgjidh një mjet komunikimi që është i përshtatshëm për mesazhin që do të dërgohet;
- Zgjidh një mjet komunikimi që nxënësi është në gjendje që ta përdorë dhe monitorojë;
- Shmang filtrimin dhe deformimin e informacionit;
- Sigurohu që është ndërtuar mekanizmi i marrjes së feedbackut/përgjigjes në mesazhin e dërguar;

7- Aftësitë komunikuese të mësuesve si marrës/pritës të mesazheve

o Kushtoji vëmendjen e duhur mesazheve!

Për shkak të roleve dhe detyrave të tyre të shumëfishta, mësuesit janë shpesh të mbingarkuar dhe të detyruar të mendojnë për shumë gjëra në të njëjtën kohë. Të tërhequr në shumë drejtime të ndryshme, ata ngandonjëherë nuk i kushtojnë vëmendjen e mjaftueshme mesazheve që marrin. Sidoqoftë, për të qënë efektive, mësuesit duhet gjithmonë t'i kushtojnë vëmendje mesazheve që ata marrin, pavarësisht sesa të zënë me punë ata janë.

o Ji një dëgjues i mirë !

Mësuesit mund të bëjnë gjëra të ndryshme për të qënë dëgjues të mirë:

Së pari, mësuesi duhet të përmbahet nga ndërprerja e nxënësit gjatë dhënies së mesazhit në mes të mesazhit, kështu që kjo do të bëjë që mësuesi të mos e humbasë fillin e mendimeve të tij dhe nxënësit nuk kërcejnë menjëherë në nxjerren e konkluzioneve të gabuara bazuar në informacione jo-komplete;

Së dyti, mësuesit duhet të mbajnë një kontakt të mirë me sy me nxënësit, që mësuesi të ndjejë që nxënësit po i kushtojnë të gjithë vëmendjen e nevojshme.

Së treti, mësuesit duhet të parafrazojnë, ose të rishprehin me fjalët e tyre, pikat më të rëndësishme nga mesazhi i nxënësit, ose pikat më komplekse apo të hapura për interpretime të ndryshme.

o Ji empatik!

Nxënësit janë empatik kur ata përpiqen të kuptojnë se çfare ndjen mësuesi dhe përpiqen të interpretojnë një mesazh nga pikëpamja e mësuesit të tij; se sa ta shikojnë mesazhin sipas pikëpamjes së tyre personale.

8- Aftësitë Komunikuese të Mësuesit për të Kuptuar Stilet Gjuhësore

Në shkencën e mësimdhënies thuhet shpesh se teknika e mësimit nuk është gjë tjetër veçse një stil gjuhe. Kjo bëhet për të theksuar rëndësinë e madhe që kanë në komunikim çështje që kanë të bëjnë me diferencat linguistike midis njerëzve. Këto diferenca kanë lidhje me faktorë të shumtë demografik, por midis tyre dallojmë: diferencat midis kulturave të ndryshme dhe diferencat midis gjinive të ndryshme.

10-Mësimdhënia përmes komunikimit

Të mësuarit përmes komunikimit është një proces i bazuar në njohuri interpretuese. Mësuesi ka për detyrë të drejtojnë nxënësit rreth një çështje të caktuar që mund të përbëjë thelbin e materialeve të organizuara për atë orë mësimi, duke i nxitur ata të diskutojnë rreth mënyrës sesi e perceptojnë apo vleresojnë temën e diskutimit. Komunikimi, empatia dhe arsyetimi janë element të rëndësishëm që e bejnë me efektiv procesin e mesimdhënies. Dialogu dhe mbështetja reciproke janë shtyllat e procesit të mësimi përmes komunikimit.

Një nga elementët më të rëndësishëm të procesit të komunikimit në klasë është aftësia për të ‘lexuar’ studentët. Kjo do të thotë që një mësues i aftë mund të kuptojë:

- kur mendja e nxënësve është shpërqëndruar,
- kur ritmi i dhënies mësim është ngadalësuar, duke e bërë orën të mërzitshme,
- kur duhet ndaluar për të hedhur një ide për diskutim
- kur nxënësit duan të dëgjojnë më shumë dhe çdo situatë tjetër të mundshme.

Një aspekt i rëndësishëm për të qënë një lider motivues i suksesshëm është komunikimi. Mësuesit shpenzojnë pjesën më të madhe të kohës të angazhuar drejtëpërsëdrejti në forma të caktuara të procesit të komunikimit. Nëse procesi i komunikimit në klasë është me probleme atëherë kjo do të ndikojë në të gjitha situatat e tjera. Madje edhe kur arrijmë të zbulojmë gabimet mund të ndodhë të jemi shumë vonë ose nuk arrijmë që të kuptojmë gabimet e trashëguara gjatë procesit të cilat pasojnë gabime të tjera. Komunikimi efektiv i informacionit real ndodh që të jetë i vështirë por shpreh qëndrimet dhe ndjenjat duhet që të komunikohen dhe pikërisht kjo e vështirëson akoma më tepër situatën në klasë. Mësuesit duan të marrin në punën e tyre vendime të rëndësishme dhe korrekte ata duhet t’u trajtojnë procesin e komunikimit në mënyrë sa më efektive. Si rrjedhim nevoja për të zhvilluar aftësitë e një komunikimi efektiv duhet të jetë prioritet mjaft i rëndësishëm. Aftësitë komunikuese lihen pas dore dhe ekziston më shumë tendenca për të nxjerrë më në dukje mungesën e aftësive të nxënësve, se sa dëshira për të parë brënda vetes. Për të qënë një mësues efektiv bashkëpunues duhet ta shohim eksperiencën tonë si diçka që duhet ta ndajmë me të tjerët, për të ndihmuar në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në tërësi.

10-Komunikimi i Mësuesit Dje dhe Sot

11.1. Mësuesi Dje

Komunikimi në klasë dikur kishte arritur në kufijet e një “idhulli”, ku mësuesi ishte i paprekshëm, i pagabueshëm dhe kur nxënësi përballej me të ndëshkohej nëse prishte atmosferën në klasë. Mësuesi dje ishte i plotfuqishëm dhe përdorte të gjitha format e poshtrimit të figurës së nxënësit të cilat ulnin shkallën e komunikimit të ndërsjelltë mësues-nxënës.

Ai kishte të drejtë të ndëshkonte fizikisht dhe moralisht nxënësit e tij me shikim vëngër, t’i hiqte një pëllëmbë, i shkulte veshin, përdorte thuprën, ulërinte dhe mund të përdorte lloj-lloji nofke të nxënësit e tij.

Në shumicën e rasteve komunikimi mësues-nxënës ishte i njëanshëm, duke përjashtuar ose penalizuar të gjithë ata fëmijë, të brishtë psikologjikisht, duke i arratisur në një botë tjetër.

Edhe raporti i komunikimit mësues-prind vuante sërish nga i njëjti kompleks tradicional, ku asnjëra palë, në jo pak raste, nuk dinte se ç'farë kërkonte në të mirë të edukimit të shëndetit mendor të fëmijës dhe si pasojë të dyja palët ndëshkonin fëmijën, në vend që të rrisnin shkallën e komunikimit dhe të ndëshkonin gabimin. Nxënësit shpesh binin në depresion sepse dhunoheshin edhe nga mësuesi dhe nga prindi. Dhunimi fizik kryhej me thupër thanë ose mjete të tjera të forta që linin gjurmë në trupin e fëmijës.

11.2. Mësuesi Sot

Mësuesit e ditëve të sotme kanë përqafuar një qasje të re komunikimi dhe kanë ridimensuar rëndësinë e komunikimit të ndërsjelltë me nxënësit e tyre në funksion të mësimdhënies. Mësuesi model monitorohet në çdo moment të veprimtarisë së tij në shkollë, që nga mënyra e komunikimit, sjellja, lëvizjet, gjestet etj, dhe është i skanuar nga sytë e përqëndruar në një pike nga nxënësit e tij. Kështu ai duhet të zotërojë situatën, për të shmangur çdo thyerje disipline dhe mbi të gjitha të realizojë me sukses procesin mësimor, i cili çon në prodhimin e vlerave edukative. Komunikimi arrin rezultatet e dëshiruara, kur nxënësve përveç dijeve u falim buzqeshje dhe dashuri. Mësuesit sot janë tolerant, të arsyshëm për zgjidhjen e problemeve në ambjentet e shkollës dhe jashtë saj.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që e bën të suksesshëm mësuesin në ditët tona është dhe organizimi i punës edukative në grup, pra në kolektiv i parë si faktori vendimtar në edukimin e brezit të ri. Mësuesi sot shikohet në këndin e barazisë me nxënësin për nga mënyra e veshjes dhe kushteve të jetesës, ç'ka i bën që midis familjes së nxënësit dhe mësuesit mos të ketë disnivele në mënyrën e të mënduarit dhe të jetuarit. Masa më e madhe e mësuesve i janë larguar dhunës dhe sharjeve dhe janë më human me nxënësit e tyre.

12-Konkluzion: Komunikimi i Mësuesit Motivues Ndaj Nxënësve

“Nga psikologjia është e njohur se me nocionin motivim i nxënësve nënkuptohet sistemi i nxitjeve, shtytjeve apo i cjtjeve të aktiviteteve intelektuale, emocionale, sociale, motorike e kështu me radhë.” Motivimi është faktori kryesor i mësimdhënies dhe nxitësi i cili e shton aktivitetin e nxënësve, interesimin dhe vullnetin e tyre. Andaj, jo rrallë thuhet se mësimdhënësi i mirë i tërheq nxënësit sikur magneti tërhmijat e atomit. Pra, motivimi është proces i cili inicohet nga mësimdhënësi, dhe vetëm ai mund ta bëjë këtë duke pasur në zbatim mjete dhe praktika efektive, të cilat do të ndikojnë pozitivisht tek subjektet. Kjo do të thotë se krijimi i një mjedisi pozitiv në klasë arrihet vetëm përmes motivimit të nxënësve në mësim. Një faktorë thelbësor i cili ndikon në motivimin e nxënësve, është ekologjia (mjedisi, ambienti) e klasave, struktura e saj, pajisja me variacione atraktive dhe posedimi i mjeteve mësimore stimuluese. P.sh. një klasë e cila posedon banga dhe karrige kualitative e të pastra, harta e portrete të ndryshme, punime të nxënësve të vendosura në muret e klasës, projektorë e ilustrime të tjera, janë faktorë parcial, por që kanë efekt në motivimin e nxënësve. Në metodologjinë e mësimdhënies thuhet se komponentët kryesorë të motivimit të nxënësve janë:

a- motivimi i brendshëm,

b- motivimi i jashtëm,

c- shpresa për sukses.

Motivimi i brendshëm ka të bëjë me shkallën në të cilën nxënësit merren me një veprimtari,

me qëllim që të plotësojnë ose kënaqin kuriozitetin dhe interesin e tyre për një temë të caktuar në kuadër të një lënde. P.sh. ka disa nxënës të cilëve u pëlqen Historia apo Gjeografia, dhe ata punojnë shumë në atë lëndë. Ky është motiv i brendshëm. Ndërkaq, motivi i jashtëm ka të bëjë me tërheqjen në një veprimtari me qëllim që të arrihen disa synime, të cilat shpërblehen, p.sh. lëvdata nga prindërit dhe mësuesit mund të jenë si lloje të stimulimit të jashtëm. Shembull: nëse një nxënës e do dhe interesohet për lëndën e Biologjisë (motiv i brendshëm) për të kjo lëndë është shumë e rëndësishme që të arrijë qëllimin në realizimin e dëshirës për profesionin e ardhshëm (motiv i jashtëm). Shpresa për sukses ka të bëjë me atë se çdo detyrë që i ngarkohet nxënësit duhet të jetë në përputhje me shkathtësitë psiko-fizike të tij, dhe ngarkesa në rangun e mbimesatares së mundësive të nxënësit është e lehtë dhe e mundshme për të. Natyrisht që në çdo fillim ai e prognozoi problemin dhe e parasheh zgjidhjen e tij. Kur zgjidhet problemi, tek nxënësit arrihet kënaqësia, dhe ky veprim apo sukses e stimulon atë të ballafaqohet edhe me detyra më të mëdha, por pa shkaktuar vështirësi në zgjidhjet e tyre.

Në anën tjetër, duke iu shmangur pakëz këtij trajtimi disi të komplikuar, të vështrojmë konceptin e konkretizimit të këtij faktori nga këndvështrimi i mësimdhënësit. Tani jemi në dijeni se në shumicën e shkollave tona, sidomos në ato të ciklit të ulët, procesi mësimor realizohet përmes formës së punës në grupe, por ka raste edhe kur realizimi i saj bëhet edhe përmes formës në çifte.

“Në literaturën didaktike dhe psikologjike më së denduri përmenden këto mjete stimuluese: lëvdata, dhurata, qortimi, premtimi, garat, bashkëpunimi, informimi përkitazi me rezultatet e arritura, etj.” (Haliti, 2003, f.38). Pra, këto mjete duhet të përdoren me vend dhe në mënyrë adekuate. Sigurisht që kërkesa dhe dëshira e mësimdhënësit është që të dëgjojë dhe respektojë mendimin e nxënësve. Do të ishte shumë konstruktive, nëse çdo mendim, opinion, mirëpritjet nga mësimdhënësi me kërshtëri, habi dhe interes të madh. Madje një përsëritje e këtij mendimi apo angazhimi me një vlerësim si “të lumtë”, “vazhdo kështu se shumë mirë është”, “falënderit për mendimin tuaj, ishte mjaft i interesant”, etj., lënë përshtypje pozitive për nxënësin dhe ai tani krijon bindjen se është subjekt i cili mund të kontribuojë në vetvete dhe në klasë.

Po ashtu, mësimdhënësi duhet t’i stimulojë nxënësit edhe përmes premtimeve dhe dhuratave, por duhet të jetë i vëmendshëm se nëse ato nuk realizohen me kohë dhe me vend, kanë gjasa të destimulojnë veprimtarinë e mëtutjeshme të nxënësve në lëndën përkatëse. Kërkohet vazhdimisht që të aktivizohen nxënësit të cilët rrinë mbyllur, të pamotivuar, të painteresuar apo që janë intravert. Arsimitari me kohë duhet t’i verifikojë dhe identifikojë rastet e tilla, dhe të ndër marrë masat e nevojshme në integrimin e tyre në proces, sepse edhe ata kanë aftësi dhe shkathtësi kreative, por u mungon kurajo, guximi dhe trimëria për t’i shfaqur ato. Derisa bëjmë fjalë për motivimin e nxënësve, duhet të theksojmë këtu edhe disa sugjerime që transmeton Bonnie Miller:

- a- Përforco vetëbesimin,
- b- Lavdëro përpjekjet dhe progresin,
- c- Mëso fëmijët se ata janë përgjegjës për ngritjen e tyre intelektuale,
- d- Pranoj gabimet si mjete për të mësuar,
- e- Zgjerohu në fusha të suksesshme në shkollë dhe jashtë saj,
- f- Përshtateni materialin me jetën dhe qëllimet e tyre.

Referencat

Demo.E & Dollani P. (2007) “Komunikimi në biznes”

Lamnos, B. (2002) “Good listeners are better communicators” Publikues: Pitman

Chaney and Martin, (2000) “Intercultural Business Communication” Publikues: Prentice Hall

Deborah Roebuck, (2006) “Improving Business Communication Skills” Kennesaw State College, Publikues: Prentice Hall

http://www.docstoc.com/docs/59417643/Udh%EF%BF%BDheqja?utm_source=email&utm_medium=email&utm_campaign=2&utm_content=2606

Haliti, Shefik. “Në kërkim të pedagogjisë reformuese”, KURORA, 2007.

Haliti, Shefik. “Artikuj të përzgjedhur pedagogjikë”, URA, 2003.

Musai, Bardhyl. “Metodologji e Mësimdhënie”, Tiranë: Pegi, 2003.

Miller, Bonnie. “Komunikimi me fëmijë” (Doracak për prindër dhe arsimtar). Ferizaj: QPEA, 2005.

Manxhari, Mimoza. “Sjellja në Organizatë” Tiranë 2010.